

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Transporti i nxënësve të shkollës Luigj Gurakuqi për vitin 2026”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):CPV 60130000-8 -Shërbime rrugore të veçanta për transportin e pasagjerëve.

VLERA E FONDIT LIMIT: 2.416.666 (dymilion e katërqind e gjashtëmbëdhjetëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë), pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor Shkolla Speciale Luigj Gurakuqi ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP nr. 162 datë 23.12.2020, i ndryshuar si dhe nenin 26 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është 48.333,32 (dyzet e tetëmijë e treqind e tridhjetë e tre presje tridhjetë e dy) lekë, të lëshuar në formën e garancisë bankare ose nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të LPP, i ndryshuar si dhe nenit 30, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar), ku mes të tjerave citohet se: “...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël...”

“...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe...”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Licenca profesionale e subjektit për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të udhëtarëve, lëshuar nga QKL.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, i ndryshuar, nenit 41, pika 4, gërma (a), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), si dhe në mbështetje të Ligjit 8308, date 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, (i ndryshuar) dhe Nenit 4 të Udhëzimit 5627, datë 18.11.2016 “Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe dokumenteve për lëshimin e licensave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”.

2.1.2 Çertifikatë ISO 9001 ose ekuivalente për transport udhëtarësh, i vlefshëm.

Argumenti: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, i ndryshuar si dhe në VKM-në Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 44 - Kërkesat e cilësisë, pika 1 ku citohet:

Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël **966.666 (nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtëmijë)** lekë pa TVSH lëshuar nga Autoriteti përkatës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 61, të Ligjit Nr. 29/2023 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", (i ndryshuar), ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", (i ndryshuar), VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (b) të nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Kërkohet vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025, në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës, referuar nenin 43 pika 2/b, të VKM nr. 285,

datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, pasi kjo është një procedurë e Hapur - nën kufirin e ulët monetar, dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare dhe kapaciteteve ekonomike të operatorëve ofertues, se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika ”c” të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, kur bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 61, të Ligjit Nr. 29/2023 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, (i ndryshuar) si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, gjithashtu është kërkuar auditimi ligjor i pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese në rastet e parashikuara në nenin 41, pika ”c” të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar).

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetimet që dëshmojnë se operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2026 sipas afateve të përcaktuara në ligjin nr. 9632/2006 ”Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Kriteri sipas pikës 2.2.3 do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit ku operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2026 sipas parashikimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 (i ndryshuar). Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 76, pika 2, gërma ”b” të LPP si dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), neni 5, pika ”c”, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2023 në të gjitha vendet ku ushtron aktivitet ekonomik sipas të dhënave të QKB-së

Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 . Dëshmi për shërbime të mëparshme, të ngjashme, me objektin e prokurimit të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës me vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate dhe konkretisht: **483.333 (katërqind e tetëdhjetë e tremijë e treqind e tridhjetë e tre)** lekë pa TVSH.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Kur përvoja e mëparshme e ngjashme është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e shërbimeve të furnizuara.
- Kur përvoja e mëparshme e ngjashme është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë duke paraqitur faturat përkatëse tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 41, pika 3 (*ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

2.3.2 Drejtuesi teknik i shoqërisë të jetë i pajisur me Çertifikatën e Kompetencës Profesionale, lëshuar nga DPSHTRR (Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor) e lidhur me objektin e prokurimit veprimtari e transportit të udhëtarëve.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht është kërkuar drejtuesi teknik i shoqërisë i pajisur me Çertifikatën e Kompetencës Profesionale në mbështetje të VKM 325, datë 19.03.2008 "Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe udhëtarëve, si dhe për dokumentacionin zyrtar të caktuar për këta operator" (i ndryshuar), Kapitulli II, pika 2.

2.3.3 Një punësim mesatar i të paktën 10 (dhjetë) personave, për periudhën Janar 2026 – Mars 2026 të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore mbi numrin e punonjësve të siguruar për periudhën Janar 2026 – Mars 2026.

Kriteri sipas pikës 2.3.3 do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin

provues për vetëdeklarimin në lidhje me numrin e punonjësve të deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), si dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), vendosja e këtij kriteri është e domosdoshme për të garantuar që operatorët ekonomikë disponojnë kapacitetin real njerëzor për realizimin korrekt dhe të pandërprerë të objektit të prokurimit.

Kërkesa për një numër minimal punonjësish nuk është formale, por lidhet drejtpërdrejt me natyrën dhe specifikat e shërbimit që do të ofrohet. Duke qenë se objekti i kontratës përfshin transportin e nxënësve të një shkolle speciale, ku nxënësit janë me nevoja te veçanta dhe kërkohet në çdo rast prania dhe kujdesi i shoqëruesve, disponueshmëria e stafit të mjaftueshëm është kusht thelbësor për garantimin e sigurisë, mirëqenies dhe trajtimit të duhur të fëmijëve.

Për më tepër, një numër i pamjaftueshëm punonjësish do të rrezikonte jo vetëm cilësinë dhe vazhdimësinë e shërbimit, por edhe përmbushjen e detyrimeve kontraktore, duke krijuar pasoja të drejtpërdrejta për autoritetin kontraktor. Në këtë kuadër, ky kriter është proporcional, i arsyeshëm dhe i lidhur ngushtë me objektin e prokurimit, duke synuar të përzgjedhë operatorë ekonomikë që kanë kapacitetet e nevojshme për të përmbushur me përgjegjësi këtë shërbim me ndjeshmëri të lartë.

2.3.4 Automjeti (Autobuzi), duhet të jetë me të gjitha kushtet bashkëkohore dhe moderne dhe të ketë:

- Kondicioner;
- Viti i prodhimit mbi 2005;
- Të ketë mbi 30 vende.

Dhe për automjetin (Autobuzin) duhet të paraqiten dokumentat e mëposhtme :

- a. Dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (Leje Qarkullimi).
- b. Çertifikatë pronarie e mjetit.
- b. Çertifikata e kontrollit teknike të mjetit, i vlefshëm.
- c. Siguracioni i mjetit, i vlefshëm.
- d. Akt vlerësimi i plotësimit të kushteve të komoditetit, i vlefshëm.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.3.5 Deklaratë lëshuar nga administratori i shoqërisë, ku të jetë i përcaktuar emri i drejtuesit të automjetit (Autobuzit), dhe emrat e shoqëruesve (femra) si dhe të jetë i përcaktuar se këta persona do të jenë të pranishëm gjatë të gjithë kohës që do të realizohet shërbimi i transportit.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar në stafin e tij 1 (një) punonjës drejtues mjeti i cili të figurojë në list pagesën e shoqërisë për periudhën Janar 2026-Mars 2026. Për drejtuesin e mjetit duhet te paraqitet dokumentacioni sa më poshtë:

- a. Kontratë pune e vlefshme.
- b. Leje drejtimi automjeti të klasit D, e vlefshme.

Kriteri sipas pikës 2.3.6 do të konsiderohet i përmbushur nga operatori ekonomik gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentet

përkatëse provuese sa më sipër përcaktuar do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e tij 2 (dy) punonjëse (femra) shoqëruese të fëmijëve të cilat të figurojë në list pagesën e shoqërisë. Shoqërueset duhet të kenë eksperiencë në punën me fëmijë me aftësi të vecanta. Për shoqërueset e fëmijëve duhet të paraqitet dokumentacioni sa më poshtë:

- a. Kontratë pune (të vlefshme për të gjithë kohëzgjatjen e shërbimit)
- b. CV (ku të specifikohen eksperiencat në punën me fëmijët me aftësi të vecanta).
- c. Vërtetim të lëshuar nga punëdhënësi ku të specifikohet dhe referohet eksperiencë e punës me fëmijë me aftësi të veçanta.

Kriteri sipas pikës 2.3.7 do të konsiderohet i përmbushur nga operatori ekonomik gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentet përkatëse provuese sa më sipër përcaktuar do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht drejtuesi i mjetit me kualifikimin perkates si dhe shoqërueset e fëmijëve të cilat duhet të paraqesin kontratën e punës, CV dhe vërtetime nga punëdhënësi që vërtetojnë eksperiencën e tyre në punën me fëmijë me nevojë të veçanta.

Është cilësuar që shoqërueset të jenë femra, dhe të kenë eksperiencë në punën me fëmijë me aftësi të veçanta referuar specifikës që kanë këta fëmijë të cilët kanë kufizime të veçanta shëndetësore, dhe gjendja fizike e tyre është e rënduar. Gjate kryerjes së veprimtarisë së transportit të përditshme këta fëmijë hasin vështirësi fizike, biologjike dhe kognitive të nivelit të lartë. Pjesa me e madhe janë në moshën e adoleshencës dhe kanë probleme me sjelljen dhe aktivizimin e emocioneve hormonale dhe gjithashtu paraqesin nevojë të veçanta për kujdes dhe vëmendje në përputhje me llojin dhe shkallën e kufizimit të tyre. Për këtë arsye janë zgjedhur gjithmonë shoqëruese femra për këta fëmijë sikundër përcaktuar dhe në dokumentat e procedurës së prokurimit të cilat plotësojnë aspektin mëmësor si dhe kujdesin social femëror ato kujdesen gjatë transportit për higjienën personale të fëmijëve që nga pastrimi fizik dhe deri tek ndërrimi i veshjeve intime.

Sa më sipër autoriteti kontraktor nëpërmjet kërkesës për pasjen gjithmonë të shoqërueseve femra në dispozicion të këtyre femijeve, ka patur parasysh që të ndihmojë këta individë të arrijnë dhe të mbajnë funksionim optimal në bashkëveprimin me mjedisin e tyre. Në të kundërt ndërveprimi dhe përshtatshmëria e këtyre fëmijëve do të ishte mjaft e vështirë dhe do të pengonte ecurinë normale të procesit të tyre të përditshëm sikurse dhe transporti dhe shoqërimi për në shkollë.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe

çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i punës i ngritur për hartimin e specifikimeve teknike duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor sipas parashikimeve të nenit 36 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) sa më poshtë:

Vëndet e marrjes së fëmijëve në mëngjes për në drejtim të shkollës ”Luigj Gurakuqi”, Tiranë dhe i lënies së fëmijëve në drekë në vendet e banimit pas procesit të mësimet.

Nr.	Vendi i marrjes dhe i lënies së nxënësve
1.	Çerek
2.	Bashkia Kamëz
3.	Laknas
4.	Rreth rrotullimi Bathores
5.	Rreth rrotullimi Kamëz
6.	Stacioni i fundit Laknas
7.	Te 3-katshi Kamëz
8.	Frutikulturë Kamëz
9.	Rruga Bathore
10.	Fafa Insitut
11.	Tek Treshi
12.	Kthesa e liqenit Paskuqan
13.	Tek Karburant Ahmati Paskuqan
14.	200 metra mbi karburant Ahmati Paskuqan
15.	Kthesa Paskuqan
16.	Shkolla Paskuqan
17.	Gomisteri Paskuqan
18.	Lokali afer kryqëzimit Paskuqan
19.	Pallati kuq Paskuqan

20.	Depoja e ujit Paskuqan
21.	Te Mermeri
22.	Kaburant Alpet Babrru
23.	Qender Babrru
24.	Karburant i vogël Babrru
25.	Parku i Bashkisë
26.	Supermarket Babrru
27.	Stacioni paskuqan rreth rrotullimi
28.	Big market Allias
29.	Furra e bukës Allias

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Marrja e nxënësve nga pikat e lartpërmendura fillon në orën 6.30 sipas itinerarit të pikave të sipërcituara.

Drejtuesi i mjetit për shkak të specifikës që kanë këta fëmijë (pasi fëmijët janë me aftësi të kufizuara, prapambetje mendore dhe autizëm) është i detyruar që të presë në vëndet e përcaktuara si më lart deri në momentin e paraqitjes së fëmijës apo të marrjes së njoftimit nga prindi për mosparaqitje.

Kërkesat për shoqërueset (femra):

- Operatori ekonomik duhet të sigurojë 2 shoqëruese (femra) gjatë transportit të fëmijëve.
- Shoqërueset e fëmijëve gjatë transportit duhet të sigurohen nga shoqëria që realizon transportin e fëmijëve.
- Shoqërueset duhet të jenë të komunikueshme me nxënësit dhe prindërit.
- Të bashkëpunojnë me drejtuesit e shkollës për t'u përgjigjur kërkesave.
- Të kujdesen për fëmijët gjatë të gjithë kohës së transportit të tyre nga marrja e tyre nga prindërit deri në dorëzimin në ambientet e shkollës dhe anasjelltas.

Njësia e Prokurimit